

V E N D I M
Nr.516, datë 14.11.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.205, DATË
13.4.1999 "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, "Për Kodin Doganor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe të Ministrisë së Financave,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 64.1, shkronja "a) iii", ndryshon si vijon:

"detyrimet doganore të importit dhe taksa të tjera kombëtare apo pagesa të tjera, që duhet të paguhet në Republikën e Shqipërisë, për qëllime të importimit ose të shitjes së mallrave".

2. Në pikën 64.1, shkronja "a)" shtohet nënparagrafi "iv)", me këtë përmbajtje:

"iv) në përputhje me nenin 5.1 (a) (i) dhe nenin 5.8 të Shënimeve Interpretuese për Vlerën Doganore, të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), të marrëveshjes për zbatimin e nenit 7 të marrëveshjes së përgjithshme për tarifatat dhe tregtinë (GATT-1994), nga vlera doganore e parashikuar në pikën 64.1, shkronja a) të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, zbriten taksat vendore, që duhet të paguhet në Republikën e Shqipërisë për qëllime të importimit ose të shitjes së mallrave, sipas pikës 64.1, shkronja a) i) (zbritje për komisione ose për qëllime fitimi dhe shpenzime të përgjithshme)".

3. Në pikën 81 shtohet pika 81.4, me këtë përmbajtje:

"81.4. Në përputhje me nenin 7.3 të marrëveshjes për zbatimin e nenit 7 të marrëveshjes së përgjithshme mbi tarifatat dhe tregtinë (GATT-1994), në mbështetje të kërkesës së importuesit, autoritetet doganore në Republikën e Shqipërisë janë të detyruara të njoftojnë me shkrim vlerën doganore, si dhe metodat e përdorura për llogaritjen e vlerës doganore të mallit të importuar, të parashikuara në pjesën II, kreu 3 për "Vlerën e mallrave për qëllime doganore", të Kodit Doganor."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta